



**Numri:** KSC-BC-2020-05  
**Prokurori kundër Salih Mustafës**

**Vendos:** Gjykatësi i procedurës paraprake  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Pjesëmarrës parashtrues:** Prokurori i Specializuar

**Data:** 2 tetor 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Version publik i**

**“Parashtrim i Aktakuzës së rishikuar për herë të dytë për konfirmim”, parashtrimi**

**KSC-BC-2020-05/F00005 i datës 20 mars 2020**

**me Shtojcën 1 publike të redaktuar**

---

**Zyra e Prokurorit të Specializuar**

**Mbrojtësi për të akuzuarin**

**Xhek Smith**

**Julius von Bóné**

1. Më 18 mars 2020, në përputhje me Urdhrin,<sup>1</sup> Zyra e Prokurorit të Specializuar ('ZPS') paraqiti Aktakuzë të Rishikuar kundër Salih MUSTAFËS.<sup>2</sup> Nëpërmjet këtij parashtrimi, Zyra e Prokurorit të Specializuar zëvendëson Aktakuzën e Rishikuar me një aktakuzë të rishikuar për herë të dytë e cila përmban disa saktësime shtesë ('Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë'),<sup>3</sup> në veçanti për të korrigjuar mospërmendjen e urdhërimit dhe nxitjes si forma të përgjegjesisë penale, në lidhje me të cilat janë ngritur akuza të pavarura.
2. Ky parashtrim së bashku me shtojcën paraqiten me klasifikimin rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* në përputhje me rregullën 82(4).
3. Zyra e Prokurorit të Specializuar kërkon që Gjykatësi i Procedurës Paraprake ta konfirmojë Aktakuzën e Rishikuar për Herë të Dytë sipas kushteve të kërkuara në Parashtrimin e Parë dhe në Parashtrimin e 18 marsit.

**Numri i fjalëve në anglishte: 208**

/nënshkrim/

---

**Xhek Smith**

**Prokuror i Specializuar**

E premte, 20 mars 2020

Në Hagë, Holandë.

---

<sup>1</sup> Urdhër drejtuar Prokurorit të Specializuar në përputhje me rregullën 86(4) të Rregullores, KSC-BC-2020-05/F00003, 28 shkurt 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* ('Urdhri'), para.21. Më 14 shkurt 2020, ZPS-ja paraqiti fillimisht aktakuzën kundër Salih MUSTAFËS për konfirmim. *Shih* Paraqitjen e Aktakuzës për konfirmim dhe kërkesat në lidhje me të, KSC-BC-2020-05/F00002, 14 shkurt 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* ('Parashtrimi i parë').

<sup>2</sup> Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së rishikuar për konfirmim dhe kërkesave në lidhje me të, KSC-BC-2020-05/F0004/A01, 18 mars 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* ('Aktakuza e Rishikuar'). *Shih gjithashtu* Parashtrimin e Aktakuzës së rishikuar për konfirmim dhe kërkesave në lidhje me të, Shtojca 1, KSC-BC-2020-05/F0004, 18 mars 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* ('Parashtrimi i 18 marsit').

<sup>3</sup> Shtojca 1.